



**Bashkimi Demokratik Shqiptar**  
The Albanian Democratic Union



# Platforma Anti Diskriminim e Shqiptarëve në Maqedoni

21 MARS 2011

Më 21 mars, në ditën ndërkombëtare të luftës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial, Bashkimi Demokratik Shqiptar u drejtohet të gjitha institucioneve me peshë në marrëdhëniet ndërkombëtare me këtë Platformë Anti Diskriminim të shqiptarëve në Maqedoni duke kërkuar mbështetjen e tyre politike për realizimin e të drejtave të popullit shqiptar!

**KONFERENCË E RE NDËRKOMBËTARE**

**PADI E SHQIPTARËVE NË MAQEDONI**

**PLATFORMA ANTI DISKRIMINIM  
E SHQIPTARËVE NË MAQEDONI**

## ***Trashëgimia e vizioneve të vjetra në kohë të reja!***

### **VIZIONET E HAPËSIRËS SHTETËRORE NË BALLKAN DHE SHQIPTARËT**

Konfliktet e shpeshta, me të cilat është ballafaquar Ballkani perëndimor në përgjithësi dhe Maqedonia në veçanti, nuk mund të kuptohen në tërë dimensionin e tyre nëse shkoqiten nga proceset historike, që kushtëzuan një formë të veçantë të raporteve ndëretnike në këtë pjesë të Evropës.

Domosdoshmëria e një analize të hollësishme të së kaluarës nuk bëhet as për qëllime thjesht shkencore (për të plotësuar këtë kriter), e as për të ritheksuar të kaluarën, me qëllim që të mbetemi peng i saj.

Kjo qasje do të na ndihmojë që të shohim problematikën e trashëguar në kontekstin e vet real, dhe si e tillë, do të na ndihmojë për zhvillimin e një këndvështrimi të ri, i cili do të hapte perspektiva të reja, në përputhje me vizionet e integriteteve euro-atlantike.

Që të kuptohet drejt domosdoshmëria e përmbysjes së perspektivës aktuale të trajtimit të këtyre raporteve dhe krijimit të një perspektive të re, duhet të kthehemi në të kaluarën dhe të analizojmë, sidomos periudhën e krijimit të shteteve në Ballkan.

Pse pikërisht në këtë periudhë ?

Sepse, në periudhën e luftërave për krijimin e shteteve kombëtare në këtë pjesë të Evropës u përpiluan vizione dhe projekte kombëtare, që kanë kushtëzuar funksionimin e shoqërive të kësaj hapësire për gati dy shekuj rresht.

Dihet fare mirë se nuk mund të ketë mobilizim për krijimin e shtetit kombëtar pa pasur, paraprakisht, vizionin për hapësirën gjeografike, në të cilën duhet të shtrihen kufijtë e shtetit përkatës.

Derisa në Evropën perëndimore karakteristikë e vetme në procesin e krijimit të shteteve kombëtare ka qenë politika ekspansioniste (shtrirëse), fillimisht vetëm ndaj territoreve të popujve fqinjë e më vonë në përmasa kontinentale e botërore, në Ballkan politika ekspansioniste shoqërohet me

një politikë ekspulsioniste (dëbuese). Përqendrimi i këndvështrimit në këtë aspekt ka rëndësinë vendimtare, sepse na mundëson të shohim bazën ideologjike të praktikave gjenocidale. Me një fjalë, vizioni për shtetin me hapësirë të madhe dhe «pa të tjerët» do të projektojë praktika të tilla që do të synojnë «spastrimin» e territorit nga etnitë e tjera.

Si rrjedhojë e këtij koncepti, "Megali Idea" greke do të përfundojë me spastrimin etnik dhe gjenocidin mbi shqiptarët e Çamërisë, kurse projektet për "Serbinë e Madhe" (që nga Projektet e Ilia Garashaninit, Vasa Çubrilloviqit, Ivo Andriqit, Ivan Vukotiqit, Stevan Moleviqit e deri te Memorandumi i ASSHA), do të realizojnë spastrimin etnik të Sanxhakut të Nishit dhe do të përgatisin krimet kundër njerëzimit dhe politikën e gjenocidit në Kosovë.

Përqendrimi i vëmendjes në vizionet për hapësira shtetërore të "Mëdha" na ndihmon që të kuptojmë arsyet e praktikave të shpeshta të gjenocidit, që kanë ushtruar Greqia, Serbia, Bullgaria etj., në periudha të ndryshme ndaj popujve fqinjë në përgjithësi, dhe ndaj shqiptarëve, në veçanti.

Kjo qasje ka rëndësi të veçantë, sepse hedh poshtë interpretimet që synojnë të shpjegojnë politikën e gjenocidit vetëm si pasojë e regjimeve antidemokratike të Athinës, Beogradit etj.

Nga ana tjetër, të gjithë hulumtuesit shkencorë, që kanë qëndrim neutral dhe objektiv ndaj të kaluarës së kësaj pjesë të Evropës, janë unanimisht të mendimit se vetëm vizioni shqiptar për krijimin e shtetit të tyre kombëtar, që nga Programi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e deri te programet e shumta çlirimtare, nuk përmban orientimin politik të krijimit të një hapësire shtetërore "pa të tjerët". Madje, edhe termi "Shqipëri e Madhe" është produkt i qarqeve antishqiptare.

Një analizë e gjatë dhe kronologjike e implikimeve të këtyre vizioneve të shteteve të "Mëdha" do t'i kishte vlerat e veta dhe do të hidhte dritë mbi këtë barrë të trashëguar nga e kaluara e përgjakshme e popujve të kësaj hapësire gjeografike.

Megjithatë, ne do të kufizohemi vetëm në disa segmente dhe vetëm në një hapësirë që lidhet me fatin e popullit shqiptar, që aktualisht jeton në trojet e veta, nën Maqedoni.

Meqenëse Maqedonia është produkt i drejtpërdrejtë i Partisë Komuniste Jugosllave dhe u krijua në formën e Republikës brenda Federatës jugosllave, në shtjellimin e mëposhtëm do të kufizohemi vetëm në disa konkluzione.

Gjatë shekullit XIX dhe XX forma e organizimit shtetëror dhe e regjimeve politike u ndryshua disa here por «vizioni i shtetit pa të tjerë» mbeti i njëjtë.

Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene, Jugosllavia e Versajës, Jugosllavia e Titos dhe të gjitha Jugosllavitë e tjera, pa përjashtim, aplikuan politikat shfarosëse dhe diskriminuuese «ndaj të tjerëve» dhe sidomos ndaj shqiptarëve.

Të njëjtën logjikë e kanë ndjekur edhe autoritetet e Maqedonisë në raport me shqiptarët, që nga themelimi si republikë në kuadër të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Në vend të respektimit të së drejtës për vetëvendosje, që ishte premtuar për kontributet e mëdha në luftën antifashiste, pushteti i instaluar komunist i Shkupit i pasluftës së dytë botërore, aplikoi një terror të paparë ndaj shqiptarëve:

Që nga shtatori i vitit 1944 e deri në fund të këtij viti, nën akuzat e „anti-komunizmit ekstrem“ u ekzekutuan me mijëra shqiptarë: në Kumanovë me rrethinë u ekzekutuan mbi 700 shqiptarë; në Shkup me rrethinë 1400 shqiptarë; në Kampin e Gostivarit, ku kishte mbi 5000 të burgosur, 800 prej tyre u ekzekutuan, ndërsa një pjesë e madhe vdiqën nga pasojat e torturave; në Kampin e Monopolit të Tetovës ku kishte mbi 10.000 të burgosur, 1200 shqiptarë u ekzekutuan brenda natës, ndërsa mbi 5000 të tjerë i dërguan në Shkup, gjoja për t'i mobilizuar për frontin e Sremit. Asnjëri nuk u kthye që andej: në Kërçovë, vetëm nga fshati Zajaz u ekzekutuan 320 shqiptarë. Në vendbanimet e tjera shqiptare ndodhi e njëjta gjë: vrasje, burgosje, tortura... !

Ky terror shtetëror do të vazhdojë, me intensitete të ndryshme dhe në forma të ndryshme, gjatë gjithë periudhës komuniste në Maqedoni:

Krahas dhunës dhe terrorit shtetëror me përmasa të gjenocidit, që synonte asgjësimin fizik të shqiptarëve dhe realizimin e vizionit të “shtetit pa etni të tjera”, institucionet republikane të Maqedonisë aplikuan edhe politikën e

etnocidit që synonte asgjësimin e kulturës së etnive të tjera.

Në përputhje me këtë politikë, që ushtronte etnocid ndaj kulturës shqiptare, pushteti sistematikisht aplikoi asgjësimin e gjurmëve ilire që dëshmonin për vazhdimësinë e shqiptarëve në këto troje; ndaloi përdorimin e flamurit kombëtar dhe simbolet tjera me të cilat identifikoheshin shqiptarët; ndaloi emërtimin e personave me emra që kanë prejardhje ilire apo domethënie shqipe; ndërroi toponimet dhe njëkohësisht imponoi që toponimet të shkruhen dhe shqiptohen vetën në gjuhën maqedonase; u ndalua përdorimi i simboleve të identitetit kombëtar shqiptar; u mbyllën shkollat shqipe në pjesën dërrmuese të vendbanimeve shqiptare; u satanizua libri shqip dhe sidomos literatura që ishte botuar në Shqipëri; u hoqën nga repertori 99% e këngëve dhe valleve shqipe etj.

Shtylla tjetër e kësaj politike që synonte asgjësimin fizik dhe kulturor të shqiptarëve nga trojet e veta, lidhet me religjionin.

Në një sistem socialist, komunistët e kësaj republike krijuan Kishën ortodokse maqedonase. Kjo kishë nuk njihet, sot e kësaj dite, si kishë autoqefale nga asnjëra qendër e ortodoksisë (as nga Patrikana e Rosisë e as nga Patrikana e Stambollit).

Në koordinim të plotë me politikën komuniste të Maqedonisë, Kisha ortodokse maqedonase përcaktoi si orientim parësor vënien nën kontroll të kishave ortodokse të frekuentuara nga shqiptarët e besimit ortodoks.

Aplikimi i këtij orientimi strategjik pati si rezultat që sot, pas gjashtë dekadave të kësaj politike, askush nuk mund të japë një përgjigje se sa shqiptarë ortodoksë kanë ruajtur identitetin e vet kombëtar në Maqedoni. Pak, për të mos thënë hiç!

Orientimi i dytë strategjik i Kishës ortodokse maqedonase ishte humbja e të gjitha gjurmëve të katolicizmit shqiptar në Maqedoni.

Për realizimin e këtij qëllimi u aplikua sistematikisht dëbimi, shpronësimi dhe asimilimi i shqiptarëve katolikë si dhe vendosja e kontrollit shtetëror mbi kishën katolike. Koordinimi i politikës ekstreme me fondamentalizmin religjioz e lanë Kishën Katolike Shqiptare në Maqedoni pa meshë në gjuhën shqipe dhe emëruan, për herë të parë një maqedonas (Kiro

Stojanov) në krye të saj. Me këtë edhe është bërë shndërrimi i kishës katolike shqiptare të ritit romak në kishë katolike të ritit bizantin të lindjes dhe Dioqeza e Shkupit, historikisht e njohur si Krye-dioqeza e Dardanisë, është vendosur nën Krye-Dioqezën e Vërhbosne-s me seli në Sarajevë. Po rikujtojmë se Andrea Bogdani (gjyshi i Pjetër Bogdanit figurës së shquar të historisë shqiptare) ishte kryepeshkopi i parë, ndërsa Mark Sopi i fundit i Dioqezës së Shkupit, deri në ndarjen e saj nga ajo e Prizrenit në vitin 2000.

Me projektin e ndërtimit të Kishës ortodokse maqedonase mbi themelet e shtëpisë së Gonxhe Bojaxhiut (Nënës Terezë, simbolit të katolicizmit shqiptar) dëshirohet t'i jepet fund këtij objektivit strategjik.

Të vetëdijshëm se shumica e shqiptarëve në Maqedoni janë të besimit mysliman, orientim i veçantë strategjik i kësaj Kise ishte koordinimi me strategjinë politike të komunistëve, që kishin hartuar planet e dëbimit të shqiptarëve nga trojet e veta në Maqedoni.

Pas gjashtë dekadave të strategjive të koordinuara (fetare dhe komuniste!), Bashkësisë Fetare Islame iu uzurpuan shumica dërmuese e pronave, u rrënuan xhami dhe objekte të tjera të kultit fetar.

Pos vrasjeve, burgosjeve, maltretimeve, shkatërrimit të gjurmëve ilire, diskriminimit kulturor, etnik dhe religjioz, periudha komuniste në Maqedoni karakterizohet edhe me ndërrimin e strukturës së popullsisë.

Vetëm gjatë kësaj periudhe shpërngulen për në Turqi, SHBA, Itali, Kanada, Australi dhe Evropë, mbi 38 000 shqiptarë nga rrethi i Manastirit, mbi 80000 shqiptarë nga rrafshi i Pollogut dhe Malësisë së Sharrit, me dhjetëra mijë shqiptarë të tjerë nga rrethi i Velesit, Prilepit, Prespës, Ohrit, Strugës, Kërçovës, Dibrës, Shkupit dhe Kumanovës.



**Distancimi nga ideologjia dhe vizionet shtetërore, që shkaktuan kaq fatkeqësi në këtë pjesë të Evropës, duhet të jetë një nga parakushtet për integrimet në vlerat euro-atlantike.**

**Si subjekt i rëndësishëm politik, Bashkimi Demokratik Shqiptar është kategorik kundër vizioneve politike, të cilët arsyetojnë përdorimin e praktikave të gjenocidit dhe etnocidit, për realizimin e synimeve politike.**

- Bashkimi Demokratik Shqiptar do të kërkojë nga institucionet e reja të Maqedonisë që publikisht të dënohet politika e gjenocidit dhe etnocidit ndaj shqiptarëve, e ushtruar nga diktatura komuniste në Maqedoni;**

- Bashkimi Demokratik Shqiptar do të insistojë për dëmshpërbimin adekuat për të dëmtuarit dhe familjarët e të dëmtuarve të kësaj periudhe; Në këtë drejtim, Bashkimi Demokratik Shqiptar do të mbështesë të gjitha kërkesat e Shoqatës së të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë Shqiptarë në Maqedoni.**

## **Shpartallimi i diktaturave komuniste dhe aderimi në sistemin demokratik**

Pjesa e dytë e shekullit XX karakterizohet me një luftë të pakompromis në mes dy logjikave: logjikës demokratike me atë totalitare. Konfrontimet e sistemeve politike dhe ekonomike që pasqyronin këto dy logjika do të polarizohen skajshmërisht deri në kapitullimin e logjikës totalitare në dekadën e fundit të këtij shekulli.

Shpartallimi i sistemeve politike të “Bllokut Komunist” dhe ngadhënjimi i vlerave euro-amerikane në përmasa globale ngjalli shpresa se epoka e re drejt demokratizimit të shoqërive, që kishin jetuar për shekuj me radhë në sisteme totalitare, do t’u jepte fund marrëdhënieve konfliktuoze.

Respektimi i dinjitetit njerëzor dhe heqja e të gjitha formave të diskriminimit paraqesin vlerat dhe parimet themelore mbi të cilat mbështeten demokracitë perëndimore. Mbështetja në këto vlera dhe parime është rrugë e vetme për të siguruar paqen, prosperitetin dhe harmoninë në mes të popujve, kulturave dhe feve të ndryshme.

Fatkeqësisht, elitat politike dhe intelektuale të krijuara në kuzhinat komuniste, përpos aderimit në dimensionin procedural të demokracisë (sistem shumë - partiak, zgjedhje të lira etj.) vazhduan, me intensitet më të madh, logjikën e ekskluzivitetit të kombit të tyre dhe urrejtjes ndaj të tjerëve.

Shpresat u fashitën shumë shpejt kur në vend të “luftës së ftohtë” filloi “lufta e nxehtë” për krijimin e shteteve kombëtare, në përputhje me vizionet e lartpërmendura. Si pasojë e drejtpërdrejtë e përpjekjeve për të realizuar këto vizione të hapësirës shtetërore “pa të tjerët”, u shkaktuan dëme të pallogaritshme, si në aspektin e jetës dhe dinjitetit të njerëzve ashtu edhe në rrënimet materiale.

Gjatë fazës së kalimit nga sistemi një partiak në sistemin shumë partiak, përfaqësuesit politikë shqiptarë në Republikën e Maqedonisë u marginalizuan tërësisht nga vendimmarrja dhe nuk u përfill asnjë kërkesë e tyre. Republika e Maqedonisë kishte hequr nga emërtimi vetëm cilësorin “Socialiste” dhe kishte ruajtur institucionet tërësisht në duart e komunistëve.

Në këtë kontekst historik të jashtëm (shpalljet e referendumeve për pavarësimin e republikave të Federatës jugosllave) dhe të injorimit të vazhdueshëm të kërkesave legjitime të shqiptarëve, në plan të brendshëm, Parlamenti i Maqedonisë kërkoi prononcimin e popullit për pavarësinë e shtetit.

Me 8 shtator 1991 ky parlament, i dominuar nga përfaqësuesit e etnisë që identifikoheshin si maqedonas, nxori në referendum pavarësinë e një shteti ekskluziv dhe unitarist maqedonas.

Përkundër bojkotit total të referendumit nga populli shqiptar, pushteti që funksiononte me logjikën totalitare komuniste, i mbushi kutitë dhe shpalli se nga 71.85 % të pjesëmarrësve në Referendum 95 % ishin pro pavarësisë.

Në vazhdën e logjikës mospërfillëse ndaj kërkesave të shqiptarëve, komunistët e moçëm të konvertuar në “demokratë” apo “social-demokratë” të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë, me 17 nëntor 1991 miratuan Kushtetutën e re.

Sa u përket të drejtave të përkatësive të ndryshme etnike, kjo kushtetutë, në aspektin formalo-juridik, shënonte një kthim prapa në krahasim me Kushtetutën e vitit 1974.

Deputetët shqiptarë e kundërshtuan këtë kushtetutë antishqiptare, dhe për popullin shqiptar, kjo formë e organizimit shtetëror ishte jo legjitime.

Përfaqësuesit politikë të shqiptarëve, të preokupuar për t'i dhënë fund politikës diskriminuese që ushtrohej ndaj shqiptarëve, vendosën të organizojnë Referendumin në territoret që kishin mbetur ende të banuara me shumicë shqiptare.

Më 27 dhjetor të vitit 1991, Kuvendi i Autonomisë që drejtohej nga ish-kryetari i Partisë për Prosperitet Demokratik (PPD), Nevzat Halili, solli vendimin për shpalljen e referendumit për Autonomi politike territoriale të shqiptarëve në Maqedoni.

Referendumi i organizuar më 11 dhe 12 janar të vitit 1992 dëshmoi në mënyrë unanime vullnetin për Autonomi Politike dhe Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni. Nga numri i përgjithshëm i listave zgjedhore 383.539 në Referendum kanë marrë pjesë 361.292 ose 94.20% dhe për Autonomi politike dhe territoriale të shqiptarëve në Maqedoni votuan 360.928 ose 99.88%.

Në kohën kur ambiciet e krijimit të shteteve të pavarura “ të pastruara nga etnitë tjera” dominonin në programet politike të etniteteve të ish Federatës jugosllave, populli shqiptar në Maqedoni kufizohet në kërkesat e veta, dhe, siç bëhet e ditur përmes «Deklaratës së shpalljes së autonomisë-Ilirida», shqiptarët “botërisht deklarojmë të drejtën e patjetërsueshme të kombit tonë për bashkëjetesë në nivel të barabartë me popujt e tjerë të kësaj treve ballkanike dhe mbarë Ballkanin në përgjithësi.... Si rrjedhim i vuarjtjeve shumëvjeçare, ndëshkimeve arbitrare dhe privimit të së drejtës për arsim të lartë siç është Universiteti i Tetovës - Iliridës, ne shqiptarët kërkojmë të drejtën për vetëvendosje dhe vetëqeverisje në të gjitha institucionet shoqërore dhe politike në nivel të elementit shtetformues me popullin irjem-as.. që është në përputhje me rezultatet e Referendumit përmes të cilit njëzëri u shpreh vullneti i popullit për mëvetësi territoriale..”

«Klasa e re politike» e Maqedonisë, që doli nga sistemi i vjetër komunist, në vend që t`i përmbushë obligimet që dilnin nga Komisioni i Badinterit dhe të bënte tranzicionin drejt një sistemi të mirëfilltë demokratik, vazhdoi politikën e ekskluzivitetit etnik dhe i hapi luftë kërkesës së shqiptarëve për t`u trajtuar si komb shtet-formues.

Për të siguruar një mbështetje ndërkombëtare për shtetin e ri të pavarur, Maqedonia njohu të gjitha Konventat dhe Protokollet ndërkombëtare, që rridhnin nga procedura e trashëgimisë, si pjesë e Federatës jugosllave.

Madje, më 18 janar 1994, duke nënshkruar Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial dhe Paktin Lidhur me të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, - Maqedonia u zotua se nuk do të kryejë asnjë veprim apo praktikë të diskriminimit racial kundër personave, grupe personash apo institucionesh dhe se do të sigurojë që të gjitha autoritetet publike dhe institucionet publike, kombëtare dhe lokale, t`i përmbahen këtij detyrimi dhe u zotua se do të heq diskriminim racial, që me Konventat ndërkombëtare nënkupton çdo dallim, përjashtim, kufizim, ose preferenca që bazohet në racën, ngjyrën, prejardhjen ose origjinën kombëtare e etnike, gjuhën apo fenë dhe që ka për qëllim apo për efekt të

shkatërrojë ose të kompromentojë njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në kushte barazie, të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe në çdo fushë tjetër të jetës publike.

Megjithatë, në praktikë diskriminimi racial ndaj shqiptarëve në Maqedoni vazhdoi me intensitet edhe më të madh.

Në vazhdim do të sjellim shkurtimisht disa aspekte të aplikimit sistematik të diskriminimit racial në Maqedoni, në fushën ekonomike, politike dhe kulturore, që patën si rezultat revoltën e popullit shqiptar dhe shpërthimin e luftës në vitin 2001.

### ***- Diskriminimi ekonomik***

Ndryshimet e sistemit politik hapën rrugën e transformimit të ekonomisë socialiste dhe të centralizuar në një ekonomi të tregut konkurrent.

Gjatë procesit të privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, autoritetet e Shkupit aplikuan një krim të pa parë ekonomik: Fabrikat, uzinat dhe ndërmarrjet shoqërore që ishin krijuar me kontributin dhe sakrificat e të gjithë qytetarëve të Maqedonisë, ku kontributi i shqiptarëve përbënte më shumë se gjysmën e kontributeve të përgjithshme, shqiptarët pothuajse u përjashtuan nga ky proces.

Përpos disa dyqaneve dhe të një kompleksi tregtar (ende të pa legalizuar tërësisht) që ju dhanë udhëheqësve të partive politike shqiptare, tërësia e pronës (mbi 99.5%) u takoi maqedonasve. Krahas plaçkitjeve që shteti serb i bëri popullit të Kosovës, plaçkitja e kontributeve të shqiptarëve në Maqedoni përbën aktin më të rëndë që një ish shtet i “Bllokut Komunist” aplikoi gjatë periudhës së tranzicionit.

Gjatë procesit të denacionalizimit, pronarët shqiptarë u diskriminuan skajshmërisht dhe nuk arritën të marrin as 1% të vlerës së pronave të nacionalizuara gjatë periudhës komuniste.

Këto forma të plaçkitjes përbëjnë një krim ekonomik, në kundërshtim me parimet e Kartës së OKB-së dhe të institucioneve të Bashkimit Evropian. Si të tilla, ato janë të dënueshme dhe vepra penale, që nuk mund të vjetërohen.

- **Bashkimi Demokratik Shqiptar kërkon dëmshpërbimin adekuat për dëmet e shkaktuara në ekonominë e shqiptarëve në Maqedoni;**
- **Bashkimi Demokratik Shqiptar kërkon rishikimin e procesit të denacionalizimit, dhe në përputhje me këtë kërkesë, ne kërkojmë kthimin e të gjitha pronave pronarëve shqiptarë dhe aty ku nuk është e mundshme të bëhet një gjë e tillë, të kompensohen dëmet në mënyrë sa më të drejtë;**
- **Bashkimi Demokratik Shqiptar kërkon që 20 vjetët e ardhshme 50 % e buxhetit shtetëror të ndahen për territoret e banuara me shumicë shqiptare, për të kompensuar dëmin e plaçkitjes së kontributeve të qytetarëve shqiptarë;**
- **Bashkimi Demokratik Shqiptar kërkon që shteti i Maqedonisë të krijojë Fonde të veçanta zhvillimore, ku biznesmenëve shqiptarë që do të ofrojnë projekte zhvillimore, t'u sigurohen kredi afatgjata dhe pa kamatë, për të kompensuar plaçkitjen e ndërmarrjeve publike dhe shoqërore, të ndërtuara edhe me djersën dhe kontributin e shqiptarëve.**
- **Bashkimi Demokratik Shqiptar kërkon nga Bashkimi Evropian që fondet e parapara për Maqedoninë të ndahen në mënyrë që të hiqen dallimet rajonale dhe etnike në zhvillim.**

## **- Diskriminimi kulturor**

Duke e definuar shtetin si shtet unitar dhe ekskluziv të maqedonasve dhe duke e përqendruar pushtetin në duart e përfaqësuesve politikë të kësaj etnie “pushteti i ri” vazhdoi me të njëjtin intensitet, si gjatë periudhës komuniste, aplikimin e politikës së etnocidit ndaj shqiptarëve.

Nënshkrimi dhe ratifikimi i Kartës Evropiane për gjuhët nga shteti i Maqedonisë (25 korrik 1996) u bë në të njëjtin funksion si dhe nënshkrimi i Konventave tjera ndërkombëtare: sa për të fituar mbështetjen e aktorëve relevantë të demokracive perëndimore. Gjuha shqipe, si kërkesë e vazhdueshme e përfaqësuesve politikë shqiptarë, nuk u zyrtarizua në nivel shtetëror. Përkundrazi, ndiqej dhe dënohej çdo përpjekje që binte ndesh “me karakterin unitar të shtetit”

Asgjësimi i gjurmëve ilire, që dëshmonin për vazhdimësinë e shqiptarëve në këto troje, vazhdoi, ashtu siç vazhdoi ndërrimi i toponimeve dhe imponimi që toponimet të shkruhen dhe shqiptohen vetëm në gjuhën maqedonase. Po ashtu, vazhdoi ndalimi i përdorimit të flamurit kombëtar dhe simboleve tjera me të cilat identifikohen shqiptarët.

Përmes “Masakrës së Gostivarit 1997” “pushteti i ri” maqedonas i tregoi opinionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar se është po ai “pushtet i vjetër” dhe se aplikon po të njëjtat metoda për të shtypur dhe terrorizuar shqiptarët.

Për shkak të dhunës dhe politikës së diskriminimit racial, që Maqedonia aplikonte ndaj shqiptarëve, shpërtheu Lufta e vitit 2001.

Lufta, me gjithë pasojat e veta, u lokalizua vetëm në disa territore të banuara me shqiptarë, popullsia e të cilave përjetoi tmerre.

Për të evituar përmasat edhe më të mëdha të pasojave të luftës dhe përvojat e tragjedisë të mëdha në pjesët e tjera të ish Federatës jugosllave, aktorët më relevantë në marrëdhëniet ndërkombëtare, sidomos SHBA-të dhe BE-ja, intensifikuan angazhimet e tyre diplomatike dhe krijuan kushtet për përfundimin e luftës përmes bisedimeve.

## **«Marrëveshja e Ohrit» - Marrëveshje që përfundoi luftën por nuk ndërtoi paqen!**

«Marrëveshja e Ohrit» i dha fund konfliktit të armatosur dhe hapi një perspektivë të re, që problemet politike të akumuluar dhe të trashëguara nga e kaluara të zgjidhen me dialog politik.

Në vend të përkushtimit për realizimin e plotë të marrëveshjes, orientimit të energjive për realizimin e objektivave madhore për paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm, filluan obstrukcionet dhe shantazhet ndaj shqiptarëve.

Që në fillim të procesit të implementimit të kësaj marrëveshjeje, u imponua një preambulë kushtetuese, që nuk ishte në frymën e Marrëveshjes së Ohrit.

Amendamentet e Kushtetutës të miratuara pas luftës së vitit 2001 ngërthejnë në vete zbrazëti të qëllimshme, përmes së cilave, në vend të avancimit, kemi degradimin e të drejtave të shqiptarëve në rrafshin politik, ekonomik dhe social.

Krahas pengesave të mëdha në nivel të institucioneve shtetërore për implementimin e «Marrëveshjes së Ohrit», partia opozitare e asaj kohe VMRO e Nikolla Gruevskit, organizoi Referendumin e 7 nëntorit të vitit 2004, përmes të cilit u kërkua shpallja e pavlefshme dhe asgjësimi i «Marrëveshjes së Ohrit».

Edhe pse ky referendum nuk pati sukses, për shkak të bojkotimit të popullit shqiptar dhe një pjese të elektoratit të LSDM-së, është domethënës fakti se 445.000 qytetarë sllavo-maqedonas u deklaruan në favor të tij.

Situatën e bën edhe më të rëndë fakti se për interesa joparimore, përfaqësuesit e partive politike shqiptare pranuan pozitën inferiore dhe përçmuese të sanksionimit me ligj të të drejtave të shqiptarëve dhe ranë në grackën e spekulimeve statistikore, ku të drejtat u bënë objekt kalkulimesh numerike.

Dhe kjo është një nga arsyet kryesore përse nuk zbatohen në përgjithësi as teksti i ligjeve që burojnë nga «Marrëveshja e Ohrit» dhe as nuk janë në frymën e saj. Madje disa, si ligji për përdorimin e gjuhëve as nuk përputhen me dispozitat e kushtetutës.



Pas mandatit të parë qeveritar (2002-2006) në koalicion me LSDM, udhëheqësit e BDI-së deklaruan se nuk i kishin realizuar asnjë nga premtimet e veta elektorale për shkak të gjoja “sugjerimeve të ndërkombëtarëve që të mos ia ulin rejtingun LSDM-së”.

- Në vend të respektimit të ligjit për amnisti, term që nuk është adekuat për luftëtarët e lirisë, kemi burgosje masive të ish ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare;
- Në vend të rregullimit të statusit të dëshmorëve të kombit dhe përkujdesjes institucionale të familjarëve të tyre, kemi privilegje të panumërta për “branitelët maqedonas”;
- Në vend të riparimit të dëmeve materiale të luftës, u zhdukën gjurmët e 500 milion eurove, që Konferenca e Donatorëve në Bruksel i ndau Maqedonisë për zonat e dëmtuara nga lufta e vitit 2001;
- Në vend të ndarjes proporcionale të buxhetit, nuk u bë asnjë investim në vendbanimet shqiptare;
- Në vend të paqes dhe sigurisë, u ushtrua dhunë e paparë në territoret e banuara me shumicë shqiptare (mbi 500 shqiptarë u vranë dhe u plagosën në rrethana ende të pandriçuara gjatë këtij mandati katërvjeçar);
- Në vend të lirisë së premtuar, Maqedonia u shndërrua në një burg të vërtetë kolektiv për shqiptarët.

Në zgjedhjet e vitit 2006 VMRO e Nikolla Gruevskit, partia që organizoi Referendumin e 7 nëntorit të vitit 2004 (përmes të cilit u kërkua shpallja e pavlefshme dhe asgjësimi i «Marrëveshjes së Ohrit», militantët e të cilës kërkonin “dhoma gazi për shqiptarët”), mori mandatin e formimit të qeverisë.

Krijimi i koalicionit qeveritar me PDSH-në dhe injorimi i koalicionit qytetar (shumë partiak dhe shumë etnik: BDI, PPD, Partia Boshnjake, etj.) që kishte më shumë deputetë, revoltoi BDI-në, e cila nxori “kartën nacionaliste” për të mobilizuar popullin shqiptar në protesta dhe mosbindje qytetare.

Kthimi i BDI-së në Parlamentin e Maqedonisë, pas bojkotit prej disa muajsh, do të përfundojë me “Marrëveshjen e Majit 2007”.

“Marrëveshja e Majit” (në mes të kryetarëve të VMRO-së dhe të BDI-së) uli nivelin e obligimeve, lidhur me të drejtat e popullit shqiptar nga një **marrëveshje me ndërmjetësim dhe garanci ndërkombëtare në një marrëveshje gojore në prezencë të ndërkombëtarëve**. Kjo marrëveshje paraqet një grusht të fuqishëm kundër “Marrëveshjes së Ohrit”.

Kjo shpatë me dy tehe e Nikolla Gruevskit bëri se irritoi partnerin e koalicionit, PDSH-në.

PDSH-ja, për efekte të marketingut politik krijoi “krizën qeveritare” dhe denoncoi marrëveshjen VMRO-BDI si “marrëveshje antishqiptare”.

Në veçanti u denoncua:

- kompromisi BDI-së që statusi i dëshmorëve dhe invalidëve UÇK-së të zgjidhet me pako sociale, përmes ligjeve ekzistuese, dhe premtoi përsëri se do të angazhohet për një ligj të posaçëm për dëshmorët, e jo për “pako sociale”;
- kompromisi i BDI-së, “që zyrtarizimi i gjuhës shqipe të bëhet në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet ekzistuese”, dhe premtoi përsëri se do të angazhohet për një ligj të posaçëm.

“Krizë qeveritare VMRO-PDSH” përfundoi pasi Nikolla Gruevski mohoi seriozitetin e kësaj marrëveshje dhe ironizoi shqiptarët me nëntekstin se ata vetëm mund të ëndërrojnë të jenë të barabartë në këtë shtet.

Fjalimi i Kryeministrit Gruevski në Parlamentin e Maqedonisë simbolizoi fillimin e një dinamike të re antishqiptare. Dhuna në Tanushë 23 maj 2007, vrasjet në Vaksincë, vrasja në Haraçinë, vrasjet në Shkup, vrasjet në Pollog dhe vrasjet në Malësi të Sharrit ishin në funksion të krijimit të një klime, ku ndalimi i përdorimit zyrtar të flamurit kombëtar shqiptar dhe degradimi i të drejtave të shqiptarëve të lihet në heshtje.

Krejt kjo dhunë e pushtetit VMRO-PDSH ishte në funksion TË KTHIMIT PAS që partitë politike shqiptare të merren vazhdimisht me flamurin, me gjuhën dhe me problemet që është dashur të zgjidhen që moti.

Angazhimi konsekuent i PDSH-së në politikën antishqiptare uli tej mase rejtingun e kësaj partie dhe humbi legjitimitetin e plotë te elektorati shqiptar.

Me qëllim të ngritjes së rejtingut përmes krijimit të iluzionit se PDSH nuk pajtohet me degradimet që u bëhen të drejtave të shqiptarëve, PDSH-ja bëri se gjoja doli nga qeveria.

Loja e hyrje - daljeve të inskenuara nga partnerët strategjikë përfundoi me “Marrëveshjen e Marsit 2008” në mes të kryetarëve të partive (VMRO-së dhe të PDSH-së). Përmes kësaj **marrëveshjeje ndërpartiake dhe pa prezencën ndërkombëtare**, u realizua plotësisht atentati politik kundër «Marrëveshjes së Ohrit».

Përmes “Marrëveshjes së Marsit 2008” PDSH-ja përvetësoi në tërësi si të vetat qëndrimet që më parë i denonconin si antishqiptare:

- që statusi i dëshmorëve dhe invalidëve të UÇK-së të hyjë në kategorinë e të dëmtuarve të luftës dhe të zgjidhet përmes ligjeve ekzistuese (Mungon vetëm termi “PAKO SOCIALE!”);
- që zyrtarizimi i gjuhës shqipe të bëhet në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet ekzistuese, e jo përmes një ligji të posaçëm.

“Marrëveshja e Majit 2007” ktheu BDI-në në Parlamentin e Maqedonisë, ndërsa “Marrëveshja e Marsit 2008” ktheu PDSH-në në qeverinë e Maqedonisë.

E për të drejtat e shqiptarëve, asgjë!

Përkundër pjesëmarrjes aktive në degradimin dhe uljen e nivelit të “Marrëveshjes së Ohrit” me marrëveshjet ndërpartiake, BDI-ja dhe PDSH-ja do të organizojnë tërë fushatën elektorale të vitit 2008 në premtimet se:

- nëse edhe një herë marrin mandatin e popullit: do të zyrtarizojnë gjuhën shqipe; do të rregullojnë statusin e dëshmorëve të kombit; do të përkujdesen për gjendjen e mjerueshme të familjarëve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës; do të abrogojnë vendimin për ndalimin e përdorimit të lirë të flamurit kombëtar; do të bashkojnë Kërçovën me komunat rurale, që ky qytet shqiptar të mbetet shqiptar; do të lirojnë të gjithë të pafajshmit nga burgjet maqedonase; do t’i japin fund varfërisë së shqiptarëve në Maqedoni; do të punësojnë qindra mijë persona të papunë....

Si rezultat i degradimit të të drejtave të shqiptarëve nga ana e qeverisjes

VMRO-PDSH (2006-2008), autoriteti i VMRO-së u rrit jashtë mase në qarqet antishqiptare dhe ekstreme në Maqedoni. Kjo parti fitoi shumicën dërrmuese të vendeve në parlament (63 deputetë nga 120 vende në parlament).

Mandati i ri i VMRO-së me partner të ri (BDI-në) filloi me një operacion të përmasave të gjëra të dhunës:

- Nën pretekstin e luftës kundër krimit të organizuar, gjatë “Operacionit Hiri”, me qindra familje shqiptare të rrethit të Kumanovës janë bastisur dhe keqtrajtuar nga instrumentet e dhunës shtetërore (Policisë dhe njësive famëkeqe «ALFA»);
- U shkatërrua Instituti për Trashëgimi Kulturor Shqiptar, si i vetmi institucion ku duhej të përcaktohej mënyra e sistemimit të vlerave historike dhe kulturore, pa gjykuar për statusin politik të shqiptarëve, dhe u krijua «Muzeu i Lirisë», hipokrizi e pashembullt për një popull të robëruar!;
- Në vend të bashkimit të Komunës shqiptare të Kërçovës u miratua vendimi i vendosjes së 600 ushtarakëve maqedonas dhe familjeve të tyre në këtë qytet, për të ndryshuar përqindjen e strukturës së popullsisë;
- Në vend të lirimit nga burgu i shqiptarëve që padrejtësisht janë dënuar, ndodhi montimi i procese të reja gjyqësore:
- Rikthim i rasteve të ish ushtarëve të UÇK-së, që Gjykata e Hagës i hodhi si të pabaza;
- Ekstradimi i ish ushtarit të UÇK-së, Shkodran Idrizit nga Gjermania në Shkup, për t’u gjykuar;
- Dënimi i civilëve të pafajshëm për Rastin e Brodecit, me 190 vjet burg;
- Dënimi me burg të përjetshëm i tre ushtarëve të ish UÇK-së, Ismail Aqemi, Bashkim Bajrami dhe njërit nga udhëheqësit e luftës, z. Harun Aliu (Komandant Kushtrimi);
- U ekzekutuan në formën mafioze nga shteti terrorist maqedonas veprimtarët e shquar të çështjes kombëtare Harun Aliu, Shaban Zenuni, Qemajl Fejzullahu dhe Xhafer Shala.

Degradimi i vazhdueshëm i qëndrimeve të partive politike shqiptare lidhur me “Marrëveshjen e Ohrit” do të arrijë kulmin në qershor të vitit 2009, kur PDSH -ja “doli me vlerësimin se ajo e ka humbur kuptimin e vet, se asaj i ka skaduar afati, madje ajo është bërë pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë mbi standardet e reja” (Preambula e “Projekt Marrëveshje/Kontrata Politike”).

Si pasojë e përçarjeve ndërpartiake shqiptare, nga njëra anë dhe vendosmërisë së forcave politike maqedonase dhe institucioneve shtetërore nga ana tjetër «Marrëveshja e Ohrit» sot nuk reflekton as pesë parimet themelore të saj:

- për realizimin e qëllimeve politike përdoret dhunë dhe terror psikologjik;
- zgjidhjet territoriale bëhen në fuksion të privilegjeve etnike dhe kriteri etnik aplikohet ekskluzivisht në favor të atyre që identifikohen si maqedonas;
- karakteri shumë etnik i Maqedonisë nuk reflektohet në jetë publike, në ndarjen e buxhetit dhe të drejtat e qytetarëve;
- Kushtetuta, përmes boshllëqeve dhe interpretimeve “kreative”, është bërë mjet sanksionimi i të drejtave të shqiptarëve dhe nuk synon standardet ndërkombëtare;

Madje edhe Parimi i Badinterit është bërë cak i sulmeve për zhbërjen e tij përmes iniciativave për vende të garantuara për pakicat në kurriz të shqiptarëve.

- zhvillimi i pushtetit vendor, duke përfshirë edhe decentralizimin, bëhet në mënyrë etnikisht selektive.

**Bashkimi Demokratik Shqiptar kërkon nga BDI-ja, nga PDSH-ja dhe nga çdo forcë tjetër politike që merr mandate përfaqësimi nga vota e elektoratit shqiptar që të ndalin pazarllëqet partiake në dëm të «Marrëveshjes Ndërkombëtare të Ohrit».**

Mungesa e vullnetit politik që në vazhdimësi dëshmoi pala maqedonase për të zbatuar «Marrëveshjen e Ohrit», agresiviteti i shtuar i tyre kundër shqiptarëve dhe aplikimi sistematik i diskriminimit racial kundër shqiptarëve,

imponojnë një konsensus kombëtar brenda-shqiptar dhe ndërkombëtar rreth domosdoshmërisë së organizimit të një Konference të Re Ndërkombëtare për Maqedoninë.

Situata është tejet dramatike dhe e tensionuar.

Kjo situatë kërkon që forcat politike kombëtare dhe bashkësia ndërkombëtare të veprojnë me mençuri për të dëshmuar kapacitetet preventive.

Çdo neglizhencë e kësaj situatë na bën përgjegjës të gjithëve dhe secilin në përputhje me peshën e vet politike në skenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Para se të formulojmë kërkesën për Konferencë të Re Ndërkombëtare për Maqedoninë, ne do të sjellim disa argumente që dëshmojnë për seriozitetin e intervenimit urgjent, për të evituar një tragjedi të re në këtë pjesë të Evropës.

## DISKRIMINIMI RACIAL NË MAQEDONI

Më lart kemi përmendur faktin se për të siguruar një mbështetje ndërkombëtare për shtetin e ri, të pavarur, Maqedonia njohu të gjitha Konventat dhe Protokollet ndërkombëtare, që rridhnin nga procedura e trashëgimisë si pjesë e Federatës jugosllave.

Më 18 janar 1994 Maqedonia nënshkroi Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial dhe Paktin Lidhur me të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Përmes këtij nënshkrimi Maqedonia u zotua se nuk do të kryejë asnjë veprim apo praktikë të diskriminimit racial kundër personave, grupeve personash apo institucionesh dhe se do të sigurojë që të gjitha autoritetet publike dhe institucionet publike, kombëtare dhe lokale, t'i përmbahen këtij detyrimi.

Në praktikë diskriminimi racial ndaj shqiptarëve në Maqedoni vazhdoi me intensitet edhe më të madh pas përfundimit të luftës së armatosur të vitit 2001.

## Në vend të “amnistisë” - likuidime fizike dhe dënime në proceset e montuara gjyqësore

Përmes “Marrëveshjes së Ohrit”, duke theksuar rëndësinë e angazhimeve të palëve në konflikt që të ndërprehen tërësisht armiqësitë, (ndërprerjen e përgjithshme, pa kushte dhe të pakufizuar të zjarrit, pëlqimin për zgjidhjen politike të problemeve të Maqedonisë, angazhimin e qartë të grupeve të armatosura që vullnetarisht të çarmatosen dhe miratimin e ligjit për amnisti), Parlamenti i Maqedonisë (më 9 mars 2002) krijoi përshtypjen se u hap një epokë e re e marrëdhënieve ndëretnike në këtë shtet.

Iluzionet u fashitën shumë shpejt, pas realizimit të plotë të marrëveshjes lidhur me çarmatosjen e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare.

Një dhunë dhe përndjekje e përgjithshme filloi kundër ish ushtarëve të UÇK-së. Dhuna dhe terrori u ushtruan nën akuza të kurdisura të gjoja “luftës kundër krimit të organizuar”, ndërkaq motivet e vërteta të përndjekjes mbetën gjithmonë të maskuara.

Bilanci dhjetëvjeçar i kësaj dhune dhe terrori antishqiptar është tragjik:

- Mbi 500 ish ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare janë vrarë apo plagosur në rrethana misterioze, e që sot e kësaj dite nuk janë ndriçuar;
- Mbi 2000 ish ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare janë torturuar nëpër hetuesinë e shtetit maqedonas, për të pranuar veprat penale të cilat nuk i kanë kryer;
- Qindra ish ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare janë dënuar me dënime të rënda dhe kohëzgjatje të mëdha “për vepra kriminale”, që nuk i kanë kryer dhe që kanë qenë të detyruar t’i pranojnë nën torturat e tmerrshme;
- Dhjetëra ish ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare janë dënuar me burgim të përjetshëm, “për vepra kriminale”, që nuk i kanë kryer dhe që kanë qenë të detyruar t’i pranojnë, nën torturat e tmerrshme;

Edhe pse Maqedonia ka nënshkruar dhe ratifikuar me 12 dhjetor 1994 «Konventën kundër torturës, veprimeve dhe dënimeve mizore, trajtimeve çnjerëzore dhe poshtëruese» realiteti dëshmon të kundërtën: shqiptarët



rrihen, poshtërohen, çnjerëzohen, maltretohen, torturohen, dënohen, vriten dhe masakrohen me bekimin e autoriteteve politike të Shkupit;

Shumë shpesh, opinioni publik kombëtar dhe ai ndërkombëtar, patën mundësi të shihnin pamje të tmerrit dhe torturave të hetuesisë maqedonase ndaj shqiptarëve, për t'i detyruar të pranojnë veprat që nuk i kanë kryer.

Shumë shpesh, organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kanë dënuar dhunën dhe terrorin fizik e psikologjik, që autoritetet e Shkupit përdorin gjatë hetuesisë.

Dhe në fund, viti 2010 shënon vitin kur edhe autoritetet më të larta shtetërore dhe forcat politike të Maqedonisë pranuan publikisht se në Maqedoni gjyqësia ka qenë dhe është nën ndikimin e partive politike.

Vullneti për të hequr ndikimet e partive politike në gjyqësor dhe krijimin e një gjyqësie të pavarur dëshmohet, para se gjithash, me qëndrimin e qartë dhe pa ambiguitet ndaj viktimave të kësaj përzierje partiake dhe etnike në gjyqësinë e Maqedonisë.

Ky vullnet nuk mund të shprehet ndryshe veçse përmes shpalljes së menjëhershme të një amnistie të përgjithshme, që do të krijonte kushtet e nevojshme për një ekspertizë të pavarur të lëndëve gjyqësore të ish ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare!

**Bashkimi Demokratik Shqiptar do të angazhohet fuqimisht për lirin e menjëhershëm të të gjithë atyre që padrejtësisht mbajnë mbi kurizin e vet pasojat e gjyqësisë së komanduar nga partitë politike dhe riparimin e dëmeve të shkaktuara nga ky kontroll partiak i institucioneve të hetuesisë, prokurorisë dhe gjyqësisë në Maqedoni.**

## DISKRIMINIMI EKONOMIK

Si pasojë e praktikës së institucionalizuar në rrafshin ekonomik kundër shqiptarëve dhe diskriminimit të vazhdueshëm të tyre, në Maqedoni u krijua dallim i madh në zhvillimin rajonal dhe etnik.

Në të gjitha strategjitë zhvillimore, territoret e banuara me shumicë shqiptare lihen anash. Investimet dhe rekomandimet për investime, përmes bllok dotacioneve të qeverisë, bëhen atje ku nuk ka shqiptarë. Madje, edhe në territoret me shumicë shqiptare gjenden fshatra ku nuk ka shqiptarë për t'u bërë investime (Rasti i projektit investues prej 10 milion euro në fshatin Leshkë të rrethinës së Tetovës, ku nuk ka asnjë banor shqiptar, është një nga rastet domethënëse për këtë politikë diskriminuuese).

Diskriminimi bëhet edhe në investimet infrastrukturore të shërbimeve publike, në çështjet banesore dhe në të gjitha fushat që janë kompetencë e drejtpërdrejtë apo indirekte e autoriteteve qendrore.

Shqiptarët janë jashtë çdo projekti ndihme për bujqësi, vreshtari dhe blegtori, dhe në rastet kur u akordohet ndonjë ndihmë, ajo është e përmasave tallëse.

Edhe pse të gjithë duhet të sigurojnë një nivel të kënaqshëm jetese, që u përgjigjet nevojave të shëndetit dhe jetës së tyre dhe të familjeve të tyre, mbi gjysma e popullsisë së Maqedonisë jeton në varfëri të thellë. Nga numri i tërësishëm i skamnorëve, shqiptarët përbëjnë mbi 85 % të të varfërve në Maqedoni.

Ky dallim i madh në zhvillimin rajonal dhe etnik dhe varfëria e madhe që ka kapluar rajonet e banuara me shumicë shqiptare në Maqedoni bëhet preokupim edhe i institucioneve të Bashkimit Evropian.

Përmes disa raporteve të Parlamentit Evropian, i rekomandohet Qeverisë së Maqedonisë që të përpilojë politika efikase kundër varfërisë dhe të bëjë shpërndarjen e resurseve publike dhe fondeve të BE-së për të hequr dallimet rajonale dhe etnike (Pikat 27 dhe 28 të Raportit të 12 korrikut 2007 - Raporti A6-0214/2007).

Apelet e institucioneve të BE-së hasën në veshin e shurdhër të Qeverisë së Maqedonisë. Në vend të aplikimit të parimeve të solidaritetit me rajonet e

pazhvilluara dhe me etnitë që ballafaqohen me varfëri të skajshme, politika e plaçkitjes vazhdoi.

Përkundër rekomandimeve të Parlamentit Evropian, që Maqedonia të ndajë burime financiare të vetat dhe nga fondet e BE-së të investohet për t'i hequr dallimet në zhvillim, logjika diskriminuese është thelluar edhe më shumë.

Mbështetja financiare e BE-së, (që është në funksion të nxitjes së reformave ekonomike e politike dhe zhvillimin e shteteve, që të realizojnë perspektivën e tyre evropiane), në Maqedoni shihet dhe trajtohet si mjet i thellimit të mëtejme të diskriminimit të shqiptarëve në këtë shtet dhe pasurimit të oligarkisë maqedonase.

Shembull flagrant i kësaj qasje ndaj ndihmave të BE-së përbën fakti se një ditë pasi që Ambasadori i Bashkimit Evropian në Shkup, z. Ervan Fuere dhe zëvendëskryeministri për çështje të euro-integrimeve, Ivica Bocevski nënshkruan marrëveshjet financiare për realizimin e programeve nga fondet IPA të BE-së në vlerë prej 40 milion euro, Qeveria e Maqedonisë ndau 55 milion euro nga buxheti i shtetit për realizimin e projekteve zhvillimore në 11 komuna ku nuk ka shqiptarë.

Rekomandimet e institucioneve të BE-së lidhur me domosdoshmërinë e lidhjeve të transportit rrugor dhe hekurudhor të Maqedonisë me Shqipërinë dhe Kosovën sabotohen në vazhdimësi. Projektet për lidhjet hekurudhore dhe për Korridorin e VIII mbeten projekte për të cilat duhet të bëhet luftë politike kundër mentalitetit paradoksal me logjikën ekonomike.

Një shembull i diskriminimit ekonomik dhe orientimit të investimeve të huaja në territoret ku nuk ka shqiptarë paraqet ndërtimi i naftësjellësit AMBO.

Me ndërrimin e rrugës së naftësjellësit, nga shuma e përgjithshme 1.2 miliard dollar, rreth 400 milion dollar do të investohen në Maqedoni, si mjete për ndërtim të naftësjellësit. Vetëm nga taksat që do ti paguajnë kompanitë për transport të naftës nëpër Maqedoni do të përfitohet 20 - 30 milion dollar të ardhura të pastra.

Sipas Projekti të ndërtimit mbi bazën e leverdisë ekonomike duhej të

kalonte nëpërmes rrugës: Qafë Thanë - Devebair - Gostivar - Tetovë. Mirëpo me propozim të Qeverisë së Maqedonisë, rruga e naftës-jellësit u ndryshua dhe mori drejtimin Manastir – Gradsko - Koçan.

Arroganca dhe mospërfillja që institucionet shtetërore të Maqedonisë tregojnë përballë rekomandimeve të BE-së duhet të bëjnë që të rishikohet tërësisht politika e BE-së ndaj Maqedonisë.

**Bashkimi Demokratik Shqiptar kërkon:**

- që të krijohet një komision i veçantë i BE-së për të hulumtuar me-naxhimin e ndihmave të deritashme të BE-së nga ana autoriteteve të Maqedonisë,
- që të bëhet monitorimi i ndihmave të ardhshme, për të ndërprerë thellimin e diskriminimit etnik në Maqedoni,
- dhe të mos hapen bisedimet për anëtarësimin e Maqedonisë në BE, pa i plotësuar tërësisht të gjitha parakushtet për anëtarësim.

## DISKRIMINIMI I FËMIJËVE

Përmes nënshkrimit të «Konventa për të Drejtat e Fëmijës» më 2 dhjetor të vitit 1993 Maqedonia u angazhua të respektojë të drejtat dhe t'ia garantojë ato çdo fëmije, që përfshihet në juridiksionin e saj, pa asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga rraca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo opinion tjetër, nga origjina kombëtare, etnike ose shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare apo çdo gjendje tjetër e fëmijës ose prindërve të tij ose përfaqësuesve të tij ligjorë, të respektojë të gjitha të drejtat e fëmijëve që lidhen me lindjen e personit, e drejta për ndihmë dhe asistencë financiare familjes ku lind, të drejtat për arsim dhe përgatitje profesionale, etj.

Në kuadër të kësaj Platforme do të ndalemi vetëm në disa segmente që nxjerrin në shesh praktikën e njëjtë të pushtetit maqedonas në raport me shqiptarët: matja me dy kute!

### *Diskriminimi në arsim*

Diskriminimi i fëmijëve shqiptar fillon që me lindjen e tyre në Maqedoni.

- Nga papunësia e lartë dhe niveli i pabarabartë i të ardhurave kemi një trend alarmant (gjendje alarmante) të rritjes së varfërisë në mesin e familjeve me (shumë) fëmijë. Sipas raportit të UNICEF-it “Varfëria e fëmijëve në Maqedoni”, mbi 50% familjeve me fëmijë jetojnë në varfëri të skajshme. Familjet shqiptarë përbëjnë shumicën absolute të kësaj kategorie të varfërisë.

Në vend të zbutjes së kësaj situatë, Parlamenti i Maqedonisë, në seancën e mbajtur më 25 korrik 2008, miratoi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Në bazë të nenit 30, paragrafit 1 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve, nënat kanë të drejtën e beneficioneve prindërore për fëmijën e dytë, të tretë dhe të katërt, nëse jeton në komunë me rritje natyrore të natalitetit nën 2.1 sipas të dhënave statistikore të Entit Shtetëror për Statistikë të Republikës së Maqedonisë nga viti 2007.

Ligji i tillë përjashton të gjitha komunat ku jetojnë shqiptarët dhe në

formë të institucionalizuar e kthen gjendjen e periudhës komuniste, ku fëmijët shqiptarë ishin të padëshiruar në Maqedoni. Si i tillë, ky ligj është në kundërshtim të plotë me dimensionin e të drejtës “për ndihmë dhe asistencë financiare familjes ku lind...” të integruar në të gjitha konventat ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve.

Përkundër asaj se Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë, në praktikë ky ligj vazhdon të aplikohet me të njëjtin intensitet.

Logjika e dy kuteve përdoret në mënyrën më flagrante në arsim. Shkolat shqipe të të gjitha niveleve janë të lëna pas dore dhe nuk bëhen as investimet më të vogla, përderisa në shkollat e komunitetit maqedonas përgatiten kushtet e informatizimit të shkollave.

Një qasje ekstreme me përmasa shqetësuese merr diskriminimi përmes segregimit të shkollave. Nxjerrja e nxënësve shqiptarë nga shkollat ekzistuese të përziera, me bekimin e qeverisë dhe getoizimi i tyre në Shkup, Kumanovë, Strugë etj. dëshmojnë për nxitjen e urrejtjes dhe mostolerancës ndëretnike

Që nga ardhja e VMRO-së në pushtet kemi një zvogëlim drastik të buxhetit për USHT-në, si të vetmin universitet publik shqiptar. Sa për krahasim, buxheti vjetor i USHT-së, që ka shumë herë më tepër studentë se Universiteti i Shtipit (ku studiojnë ekskluzivisht maqedonasit), i ndahen 500 % më pak mjete financiare se Universitetit të Shtipit.

Respektimi i diversitetit gjuhësor përbën njëri nga shtyllat themelore të demokracisë dhe kulturës evropiane. Përmes nenit 22 të Kartës së Evropës, që ritheksohet edhe në rezolutën e Këshillit të Evropës (14 shkurt 2002), respektimi i diversitetit gjuhësor merr një rol të veçantë në integrimet shoqërore, ekonomike dhe politike, sidomos në projektin e Evropës së zgjeruar. Mbështetur mbi këto parime, diversiteti gjuhësor përben njëri nga shtyllat e funksionimit të institucioneve të Bashkimit Evropian.

### ***Diskriminimi gjuhësor***

Jo vetëm gjuhët e popujve numerikisht të mëdhenj (gjermanet me mbi 80 milion banorë) por edhe gjuhët e popujve numerikisht të vegjël konsiderohen gjuhë zyrtare të Bashkimit Evropian. Malta, me 387.000 banorë, Es-

tonia, me 1.4 milion banorë, Sllovenia, me 2 milion banorë, Letonia, me 2.4 milion banorë etj. janë popuj, gjuha e të cilëve është zyrtare në BE dhe konsiderohet trashëgimi e vlefshme kulturore e kontinentit tonë.

Shtetet që kanë integruar logjikën demokratike në sistemin e funksionimit të tyre, diversitetin gjuhësor e konsiderojnë si vlerë të madhe të trashëguar dhe në mënyrë institucionale kanë krijuar instrumentet adekuate për t'i mundësuar zhvillimin e vazhdueshëm.

Në vendimet për mësimin e gjuhëve të dyta zyrtare në këto shtete rol të rëndësishëm patën të dhënat shkencore për zhvillimin **psikofizik të fëmijëve**.

***Duke pasur parasysh zhvillimin psikofizik të fëmijëve, gjuha e dytë zyrtare integrohet në sistemin arsimor nga klasa e tretë e ciklit primar ( nga mosha 9-10 vjeçare).***

Në përputhje me logjikën e dominimit dhe të ekskluzivitetit etnik Qeveria e Maqedonisë solli vendim për t'u imponuar nxënësve shqiptarë mësimin e gjuhës maqedonase nga klasa e parë fillore. Ky vendim që eksperimenton me fëmijët shqiptarë nxiti reagime të shumta të nxënësve dhe prindërve shqiptarë.

Zyrtarizmi i gjuhës shqipe në të gjitha nivelet e institucioneve shtetërore (me status të barabartë e jo si gjuhë e dytë) krijon parakushtet që mësimi i gjuhës maqedonase për nxënësit shqiptarë dhe mësimi i gjuhës shqipe për nxënësit maqedonas në tërë territorin e shtetit mund të integrohet në mënyrë obligative nga klase e tretë e arsimit fillor. Në të kundërtën, logjika e dominimit dhe ekskluzivitetit etnik do të sjellë në mënyrë të pashmangshme bojkot të gjithanshëm dhe do të paraqes gjenerator të krizave të reja në rajon.

Neni 16 i «Konventës për të drejtat e fëmijës» përcakton qartë se “Asnjë fëmijë nuk u nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare ose të paligjshme në jetën e tij private, në familje, në shtëpi ...”

Nën pretekstin e luftës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit u ushtrua dhunë dhe terror shtetëror në Tanushë dhe Brodec. Gjatë këtyre operacioneve ushtarako-policore maqedonase, u vranë, u plagosën dhe u arrestuan me dhjetëra shqiptarë në prezencën e familjarëve të tyre.

Posaçërisht fëmijët shqiptarë përjetuan tmerret, duke qenë dëshmitarë të dhunës shtetërore ndaj prindërve të tyre.

## DISKRIMINIMI NË KULTURË

Në përputhje me logjikën që aplikoi politikën e etnocidit ndaj kulturës shqiptare për rreth gjashtë dekada rresht Maqedonia, edhe pse nënshkruese e Kartës Evropiane për gjuhët (25 korrik 1996), Konventës Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial, Paktit Lidhur me të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe angazhimeve që i dalin nga “Marrëveshja Ndërkombëtare e Ohrit” për t’i dhënë fund diskriminimit etnik në këtë fushë, sot e kësaj ditë gjuha shqipe nuk është gjuhë zyrtare në nivel shtetëror dhe shqiptarët vazhdojnë të diskriminohen në aspektin kulturor si më parë.

Në 10 vjetorin e kësaj marrëveshjeje bilanci është tejet negativ: jo vetëm që nuk u zyrtarizua gjuha shqipe në nivel shtetëror, siç parashihte kjo marrëveshje, por për 10 vjet pas marrëveshjes statusi i gjuhës shqipe dhe i komponentëve të identitetit tonë kombëtar u degradua edhe më shumë.

- Në vend të zyrtarizimit të gjuhës shqipe në nivel shtetëror zyrtarizimi i gjuhës shqipe pamundësohet edhe në nivel lokal. Komuna e Strugës është vetëm një shembull i politikës destruktive të VMRO-së në strategjinë e shkatërrimit të Marrëveshjes së Ohrit;
- Në vend të tratimit të barabartë të gjuhës shqipe nxënësve shqiptarë u imponohet mësimi i maqedonishtes nga klasa e parë e arsimit fillor, si hap i parë drejtë maqedonizimit të arsimit shqip në Maqedoni;
- Në vend të zyrtarizimit të gjuhës shqipe, Parlamenti i Maqedonisë miratoi ndryshime me të cilat parashihet mbrojtje ligjore e gjuhës maqedonase dhe e alfabetit cirilik, dhe sanksione kundër institucioneve, revistave, firmave, medie, etj., të cilat nuk përdorin alfabetin cirilik dhe gjuhën maqedonase;
- Në vend të avancimit të të drejtave të përdorimit të simboleve kombëtare Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë sjell vendim (tetor 2007) për ndalimin e përdorimit zyrtar të flamurit kombëtar shqiptar;
- Në vazhden e strategjisë së interpretimit të njëanshëm të së kaluarës që do të “arsyetonte” politikën e gjenocidit dhe etnocidit që pushteti i Maqedonisë ka zbatuar dhe përpiket të zbatojë kundër shqiptarëve,



kuzhina antishqiptare që mban emrin “Akademi e Shkencave dhe e Arteve të Maqedonisë (ASHAM)” publikoi “Enciklopedinë e Maqedonisë”.

Ky dokument i stërm bushur me të pavërteta fyese ndaj popullit shqiptar është dokumenti më luftënxitës që është bërë publik në Maqedoni.

Kuzhina luftënxitëse e Shkupit, që e quan veten “Akademi e Shkencave dhe e Arteve të Maqedonisë (ASHAM)”, në mënyrë analogjike si Kuzhina Luftënxitëse e Beogradit, që e quante veten “Akademi e Shkencave dhe e Arteve të Serbisë (ASHAS)”, falsifikimin e realitetit historik e bën në funksion të mobilizimeve politike kundër popujve tjerë.

Nga presioni i brendshëm dhe ai ndërkombëtar qeveria e Maqedonisë u detyrua të tërhiqet nga kjo “Enciklopedi”, por ajo nuk u tërhoq nga shitja dhe shpërndarja e saj.

Indoktrinimi i rinisë maqedonase me një interpretim të falsifikuar të historisë, të stërm bushur me urrejtje ndaj etnive të tjera në përgjithësi dhe ndaj shqiptarëve në veçanti, do të ketë pasoja afatgjata për marrëdhëniet ndëretnike në Maqedoni.

- U miratua dhe filloi realizimin Projekti “Skopje 2014”, për të cilin shpenzohen disa qindra miliona euro për të trasuar rrugën një etnike, një fetare dhe një gjuhësore të Maqedonisë, si dhe për ta zhveshur Shkupin nga çdo element shqiptar
- U vazhdua me shkatërrimin e trashëgimisë historike dhe kulturore shqiptare, humbjen e gjurmëve iliro-shqiptare, që arriti kulmin me vendosjen në kulm të Kalasë së Shkupit një Kishë ortodokse maqedonase.
- Lufta Globale kundër fundamentalizmit islamik ka trimëruar Kishën ortodokse maqedonase të ndërmarrë një fushatë të “pyllëzimit” të territoreve që ende kanë mbetur me shumicë shqiptare, me kisha ortodokse maqedonase! Në të njëjtën kohë, jo vetëm që nuk lejohet ndërtimi i Çarshisë së Xhamisë të djegur në vitin 2001 në Prilep, por as nuk lejohet falja e xhumasë në oborrin e kësaj xhamie.

Ende janë të freskëta pasojat e koordinimit të politikës ekstreme me

fundamentalizmin fetar ortodoks: Koordinimi i politikës ekstreme të Mi-losheviqit dhe fundamentalizmit të Kishës ortodokse serbe sollën dëme të mëdha në njerëz dhe shkatërrime materiale.

Koordinimi i politikës ekstreme antishqiptare të Gruevskit me fundamentalizmin ortodoks maqedonas paraqet një rrezik të madh për paqen dhe sigurinë në këtë pjesë të Ballkanit.

Ky diskriminim dhe kjo dhunë bëhet haptazi dhe pa fshehur ambiciet e kësaj politike luftënxitëse.

Në një numër raportesh zyrtare të SHBA-ve dhe të BE-së shprehet brengosje për acarimin e raporteve ndër-etnike dhe ndër-fetare në Maqedoni.

**Bashkimi Demokratik Shqiptar përshëndet brengosjen e tyre. Megjithatë, brengosja nuk është e mjaftueshme për të parandaluar shpërthimin e revoltës së akumuluar. Autoriteteve të Shkupit duhet t'u bëhet e qartë se kanë kaluar të gjithë kufijtë, dhe për 10 vite rresht, kanë dëshmuar mungesën e vullnetit për të hequr dorë nga logjika e politikave diskriminuese ndaj shqiptarëve.**

Heqja e regjimit të vizave për qytetarët e Maqedonisë me arsyetim se gjoja ky shtet “ka plotësuar kushtet në luftë kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit” nxori në shesh krimin politik, ekonomik dhe kulturor të Maqedonisë ndaj shqiptarëve që përbëjnë më shumë se 1/3 e popullsisë së përgjithshme të këtij shteti.

Efektet bombë të fazës së parë të spastrimit etnik modern (e që ende vazhdon) nxorën në shesh realitetin tragjik në të cilin jetojnë shqiptarëve në Maqedoni dhe faktin se ky shtet është larg standardeve të demokracive perëndimore dhe funksionon në kundërshtim të plotë me vlerat euro-amerikane.

Të kapur në panik, qarqet antishqiptare në Shkup tentojnë të zhvendosin vëmendjen në pseudo probleme dhe të paraqesin viktimat e diskriminimit racial si viktimat të manipulimeve nga ana e agjencive turistike!

Me qëllim të minimizimit të përmasave të kësaj situatë dramatike, mjeshtrit e spekulimeve statistikore shpërndanë lajmin se rreth 90 % e popullsisë së Maqedonisë ende nuk ka dalë jashtë shtetit. Kjo nuk mund të fshehë faktin se 10 % e popullsisë së këtij shteti paraqet shifrën mbi 200 mijë njerëz dhe se shumica absolute e tyre janë shqiptarë.

Me të njëjtin qëllim të minimizimit të përmasave të vërteta të diskriminimit racia, autoritetet antishqiptare të Shkupit, përmes instrumenteve të tyre, tentojnë të përqendrojnë vëmendjen e opinionit publik vetëm në rajonin Likovës.

Është e vërtetë se shqiptarët e rajonit të Likovës dhe të Malësisë së Sharrit ballafaqohen edhe me problemet që la pas lufta e vitit 2001. Por, ky realitet i hidhur nuk mund të fshehë faktin se mbi 800 000 shqiptarë të Kumanovës me rrethinë, të Shkupit me rrethinë, të Tetovës me rrethinë, të Gostivarit me rrethinë, të Kërçovës me rrethinë, të Dibrës me rrethinë, të Strugës me rrethinë, të Ohrit me rrethinë, të Prespës me rrethinë, të Manastirit me rrethinë, të Dollnenit me rrethinë, të Prilepit me rrethinë, jetojnë në kushte të diskriminimit ekstrem dhe në varfëri të skajshme.

Politika antishqiptare e Shkupit që synon shkatërrimin edhe të atyre pak të drejtave që gëzojnë aktualisht shqiptarët si “rezultat i statistikave” miratoi ligjin për regjistrimin e popullsisë, përmes të cilit përgatitet ndryshimi i strukturës së popullsisë dhe realizimi i pastrimit etnik. Duke pasur parasysh të gjitha përpjekjet e pushtetit për zvogëlimin e numrit real të shqiptarëve në Maqedoni dhe duke pasur parasysh përfaqësimin joadekuat të shqiptarëve në entet përgjegjëse për realizimin e regjistrimit Bashkimi Demokratik Shqiptar kërkon nga BDI-ja që të tërhiqet nga miratimi i këtij ligji dhe denoncojë kushtet dhe rrethanat që ndikuan te kjo parti për t’u bërë pjesë edhe e kësaj strategjie antishqiptare me pasoja të mëdha për të tashmen dhe të ardhmen e popullit shqiptar.

Ky regjistrim që duhej të fillonte me 1 prill 2011 (në ditën ndërkom-bëtare të gënjeshtreve!) përgatit gënjeshtrenë rreth strukturës së popullsisë të cilën duhet ta pamundësojmë të gjithë së bashku.

Një segment tjetër që përmban ky ligj lidhet me shqiptarët që aktual-

isht ndodhen në mërgim. Bashkëkombësve tanë në diasporë, të cilët bartën mbi supet e veta një pjesë të rëndësishme të luftës për të drejtat e popullit shqiptar, ky ligj u imponon harxhime shtesë për të ardhur në vendlindje me qëllim të regjistrimit.

Në këtë kontekst e shohim të udhës të sensibilizojmë opinionin ndërkombëtar lidhur me diskriminimin e emigracionit shqiptar në përgjithësi.

Emigracioni shqiptar që dërgon dhe sjell rreth 2 miliardë euro në vit është shndërruar në objekt të veçantë të diskriminimit dhe plaçkitjes nga shteti i Maqedonisë:

- Ministria e Arsimit të Maqedonisë financon rrogat e mësuesve të mësimit plotësues për kultivimin e gjuhës, kulturës dhe identitetit maqedonas në Australi, SHBA, Kanada edhe pse kjo gjuhë, kjo kulturë dhe ky identitet u është kontestuar nga të gjithë fqinjët e tyre dhe nuk investohet asgjë për mësuesit e mësimit plotësues për ruajtjen dhe kultivimin e gjuhës shqipe! Me para të plaçkitura financojnë gjuhën, kulturën dhe identitetin e vjedhur!
- Që në pikat doganore fillon bastisja dhe konfiskimi i parave, i mallrave, i aparateve elektrike, mjeteve teknike dhe i çdo gjëje që mund të plaçkitet;
- vetëm në vitin 2006-2010 u janë konfiskuar mjetet financiare mbi 5000 emigrantëve shqiptar dhe ndaj 2000 personave janë hapur procedura penale “për posedim devizash”! Absurd i llojit të vet por plotësisht logjike me logjikën antishqiptare që e karakterizon funksionimin e institucioneve të shtetit;
- Konfiskimi i dokumenteve të udhëtimit dhe detyrimi i dhënies së ryshfetit për të siguruar mundësinë e kthimit në vendet e punës në shtetet perëndimore;
- Dënimet marramendëse për “shkeljet” e rregullave të komunikacionit nga veturat me targa të huaja;
- Me një fjalë, kjo pjesë e popullit shqiptar që është më vitale dhe që mban mbi supet e veta barrën e asistencës financiare për zbutjen e

varfërisë në territoret e banuara me shqiptarë është e shkelur, e diskriminuar, e përbuzur dhe e keqtrajtuar nga institucionet shtetërore të Maqedonisë!

Bashkimi Demokratik Shqiptar ua tërheq vëmendjen të gjitha partive politike shqiptare të cilat mbështesin integrimin e kësaj Maqedonie në institucionet euro-atlantike, se me vetëdije apo pa vetëdije, mbështesin tragjedinë e popullit shqiptar në Maqedoni!

Përballë rrezikut që na kanoset të shndërrohemi në popull apatrid të Evropës (në persona që asnjë shtet nuk i konsideron si qytetarë të vet!) forcat politike duhet të tregojnë konsensusin minimal që njëzëri t'i thuhet STOP Maqedonisë antishqiptare!

Situata e krijuar pas fazës së parë të spastrimit etnik, imponon rishikimin e qëndrimeve nga autoritetet e NATO-s dhe BE-së ndaj Maqedonisë.

## MAQEDONIA DHE INSTITUCIONET EURO- ATLANTIKE

### **Pa heqjen e diskriminimit racial dhe pa përmbushjen e të gjitha kriterëve politike, as NATO as BE për Maqedoninë!**

Nënshkrimi i të gjitha konventave ndërkombëtare nga ana e Maqedonisë është bërë në funksion të përfitimeve të caktuara dhe të sigurimit të mbështetjes nga institucionet dhe shtetet me peshë në marrëdhëniet ndërkombëtare. Praktika dëshmon se ata veprojnë në kundërshtim të plotë me të gjitha konventat ndërkombëtare dhe në kundërshtim të plotë me vlerat e demokracive perëndimore.

Siguria e Maqedonisë dhe e kësaj pjese të Evropës nuk rrezikohet nga jashtë, por destabilizimi i vendit vjen, në mënyrë të pashmangshme, nga politika e diskriminimit permanent të shqiptarëve në këtë shtet.

Duke u nisur nga fakti se mbështetja e Maqedonisë në integrimet euro-atlantike, pa hequr diskriminimin që ky shtet aplikon ndaj shqiptarëve, është politikë shkurtëpamëse dhe nuk i shërben as paqes dhe as sigurisë afatgjate të kësaj pjese të Ballkanit, Bashkimi Demokratik Shqiptar kërkon nga të gjitha aktorët e interesuar që kjo pjesë e Ballkanit të jetojë në paqe dhe siguri që të ushtrojnë ndikimin e tyre që Maqedonia të heq të gjitha format e dhunës dhe diskriminimit racial dhe të sillet në përputhje me orientimet e Aleancës për liri, siguri, demokraci dhe vlera të përbashkëta.

Bashkimi Demokratik Shqiptar përshëndet qëndrimet parimore të deritanishme të Aleancës Verio - atlantike që anëtarësimin e Maqedonisë ta kushtëzojë me realizimin e Marrëveshjes së Ohrit, heqjen e të gjitha formave të diskriminimit që shteti maqedonas aplikon kundër shqiptarëve dhe angazhimet diplomatike për të gjetur konsensus me Greqinë, për emrin e këtij shteti.

Duke mos lënë anash asnjë nga kërkesat që kanë të bëjnë me të drejtat e shqiptarëve dhe plotësimin e të gjitha kushteve paraprake për anëtarësim në strukturat euro-atlantike, Bashkimi Demokratik Shqiptar insiston në faktin që shqiptarët duhet të integrohen edhe në bisedimet lidhur me emrin e ri të Maqedonisë.

Për këtë arsye rikujtojmë faktet se:

- Shpërbërja e Perandorisë Otomane, që u shoqërua me krijimin e shteteve të reja në Ballkan, u hapi rrugë apetiteve ekspansioniste të fqinjëve të shqiptarëve, në kurriz të territoreve të banuara me shumicë dërmuese shqiptare;
- Një pjesë e madhe e Shqipërisë Veriore dhe Shqipërisë Lindore iu aneksua Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene;
- Krahas copëtimit të territoreve, shtetet e reja të krijuara edhe mbi territoret shqiptare aplikuan politikën ekspulsioniste (dëbuese) në funksion të ndryshimit të strukturës demografike të territoreve shqiptare;
- Politika ekspulsioniste ka qenë karakteristika dominante e të gjitha regjimeve në këtë pjesë të Ballkanit Perëndimor: Mbretëria Serbo-Kroato-Slllovene, Jugosllavia e Vjetër, Jugosllavia e Titos, shteti serb dhe Maqedonia e pas shpërbërjes së Federatës jugosllave kanë aplikuar të gjitha format e presioneve dhe të diskriminimit, me qëllim të realizimit të spastrimit etnik;
- Sot, kur sytë e popujve të kësaj pjese të Evropës Juglindore janë kthyer në drejtim të strukturave euro-atlantike, autoritetet e Shkupit, me arrogancë tentojnë të imponojnë vështrimin e tyre historik, si interpretim i vetëm i të kaluarës. Ata këmbëngulin në përvetësimin e së kaluarës së huaj si pjesë të identitetit të vet.

Pengesat që nxjerr Greqia lidhur me emrin e shtetit të Maqedonisë dhe divergjencat toponimike, imponuan bisedime me ndërmjetësues të Kombeve të Bashkuara. Në këto bisedime nuk u përfillën aspak shqiptarët e Shqipërisë Lindore, territoret e të cilëve ju aneksuan fillimisht Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, e që sot bëjnë pjesë në shtetin e Maqedonisë.

Edhe pse përbëjnë më shumë se 1/3 e popullsisë së këtij shteti dhe fakti se emri i shtetit ekzistues nuk përmban asgjë që lidhet me identitetin e shqiptarëve, propozimet që vijnë për të gjetur “kompromis me Greqinë” injoron tërësisht domosdoshmërinë e komponentëve të identitetit shqiptar në emrin e ri të këtij shteti.

Propozimet lidhur me ndryshimin e emrit, dhe sidomos propozimi i fundit i ndërmjetësuesit të Kombeve të Bashkuara, z. Metju Nimic, i cili na prezantohet si propozim i mbështetur edhe nga Parlamentit Evropian, për emrin “Maqedonia e Veriut”, është i njëanshëm dhe antihistorik për shqiptarët e Shqipërisë Lindore.

Çdo tendencë që të imponohet emri që nuk ka lidhje edhe me identitetin tonë kombëtar fsheh qëllimin për të përjetësuar diskriminimin e shqiptarëve në këtë shtet. Bashkimi Demokratik Shqiptar del me propozimin që emri i ri i shtetit të jetë “Maqedonia Veriore dhe Shqipëria Lindore”.

### *Arsyetim*

- Emërtimi “Maqedonia Veriore dhe Shqipëria Lindore” do të mbulonte toponiminë reale të kësaj hapësire gjeografike;
- Emërtimi “Maqedonia Veriore dhe Shqipëria Lindore” do të integronte komponente të dy etnive që përbëjnë shumicën e popullsisë së këtij shteti;
- Emërtimi “Maqedonia Veriore dhe Shqipëria Lindore”, si emërtim që mbulon disa hapësira territoriale, nuk do të paraqiste asnjë precedencë në marrëdhëniet ndërkombëtare, nga fakti se një numër i madh i shteteve anëtare të OKB-së kanë emra të kësaj natyre (shembuj: Bosnja dhe Hercegovina, Vincent dhe Grenadine, Sao Tome dhe Principe, Antigua dhe Barbuda, Papuazia dhe Guineja e Re e shumë shtete të tjera që janë anëtarësuar në OKB para Maqedonisë);
- Figurimi i toponimit “Shqipëri” në emërtimin “Maqedonia Veriore dhe Shqipëria Lindore” nuk do të paraqiste asnjë precedencë në marrëdhëniet ndërkombëtare nga fakti se kemi numër shtetesh, anëtare të OKB-së, që kanë në emrin e tyre toponimin e njëjtë (Guineja, Guineja Bisau, Guineja Ekuatoriale, Guineja e Re).

Bashkimi Demokratik Shqiptar u bën apel të gjitha medieve që të hapin një debat publik rreth këtyre çështjeve, ku intelektualët, organizatat joqeveritare dhe qytetarët do të mund të jepnin mendimet dhe kontributet e tyre për të gjetur një konsensus minimal rreth këtyre çështjeve.



Bashkimi Demokratik Shqiptar u bën apel të gjitha forcave politike shqiptare që të harmonizojnë pikëpamjet e tyre dhe që të dalim me një qëndrim që emri i ri i shtetit të marrë parasysh komponentë edhe të identitetit të shqiptarëve të Shqipërisë Lindore, duke mos anashkaluar as toponimin «Ilirida» të Referendumit të viti 1992,

Bashkimi Demokratik Shqiptar konsideron si të domosdoshme harmonizimin e qëndrimeve dhe me një zë unik t'u drejtohem negociatorëve ndërkombëtare dhe institucioneve euro-atlantike për heqjen e diskriminimit, që nga emërtimi i shtetit e deri te të gjitha institucionet shtetërore e publike në këtë shtet.

## **Federalizimi – perspektivë reale për Maqedoninë**

Parimi themelor 1.4 i Marrëveshjes së Ohrit hap shtegun e tejkalimit të tërësishëm të konflikteve ndëretnike në Maqedoni. Në këtë parim vihet theksi se: “Një shtet bashkëkohor demokratik, në rrjedhat natyrore të zhvillimit dhe krijimit të vet, duhet vazhdimisht të sigurojë Kushtetutën e tij që tërësisht t'i plotësojë nevojat e të gjithë qytetarëve të saj, në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare si dhe të zhvillohet vetë vazhdimisht”.

Kushtetuta e Maqedonisë nuk plotëson nevojat e shprehjes dhe afirmimit të tërësishëm të diversitetit etnik, ekonomik, kulturor, fetar, gjuhësor. Përkundrazi, duke favorizuar ekskluzivitetin e maqedonasve, kjo kushtetutë është shndërruar në gjenerator të konflikteve të vazhdueshme.

Shqetësimet e mëdha dhe tensionet e vazhdueshme ndëretnike kanë hapur debatin rreth domosdoshmërisë së ndryshimeve të Kushtetutës të shtetit unitar të Maqedonisë.

Përballë kësaj domosdoshmërie, si domosdoshmëri e kohës për të ndërprerë degradimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndëretnike, ruajtësit e status quo-së, valëvisin flamurin ideologjik të unitarizmit të kamufluar me sintagmën se gjoja «nuk ka zgjidhje territoriale për çështjet etnike».

Kjo sintagmë e kamufluar, që pretendon se «nuk ka zgjidhje territoriale për çështjet etnike», fsheh qëllimin e vetëm të kësaj politike antishqip-

tare, që territori i shtetit të jetë territor në shërbim ekskluziv të një etnie.

Në rastin e Maqedonisë, kjo sintagmë tenton të maskojë realitetin se ky territor shtetëror me pasuritë e veta dhe njerëzit që jetojnë në të duhet të vihen në shërbim të atyre që identifikohen si maqedonas!

Kjo formë e funksionimit të shtetit është forma më e keqe e organizimit të shoqërive shumë etnike. Ajo nuk përmban në vete asnjë dëshirë të jetës së përbashkët. Përkundrazi, ajo shtrihet në logjikën e luftës për dominim politik, ekonomik e kulturor, dhe, si e tillë, çon në mënyrë të pashmangshme në tensione dhe konflikte ndëretnike.

Tensionet vijnë si rezultat i mosrespektimit të kompleksitetit shoqëror dhe ekskluzivitetit të një etnie ndaj etnive të tjera.

Shkurt, sovraniteti nga lart-poshtë është burim i konflikteve të vazhdueshme ndëretnike!

Nga ana tjetër, kemi filozofinë politike të organizimit shoqëror, që bazohet në sovranitetin nga poshtë - lart.

Ky sovranitet nga poshtë - lart mund të merr formën e konfederatës apo federatës, mund të shprehet me njësi autonome (të krahinave, të kantonëve apo strukturave të tjera), si ndërmjetësuese përmes të cilave sigurohet funksionimi demokratik i shoqërisë shumë etnike.

Sovranitet nga poshtë - lart paraqet formën politike, ku komunitetet e ndryshme që nuk kanë as gjuhë, as fe, e as tradita të përbashkëta, mund të bashkëjetojnë në harmoni. Është sinonim i dialogut dhe vlerave të përbashkëta ku mirëkuptimi, këmbimi i vlerave dhe dialogu i vazhdueshëm përbëjnë objektivat madhore të bashkëjetesës paqësore. Është organizimi politik, ku harmonia e pjesëve nuk shihet si konkurrente, por si plotësuese për t'i dhënë kuptim tërësisë.

Aplikimi i kësaj filozofie politike ka bërë që demokracitë perëndimore të kenë epërsinë e pakontestueshme në raport me shtetet unitare dhe të ngadhënjëjnë në përmasa botërore përballë totalitarizmit.

Sot, pas përvojave disa shekujsh të organizimit federativ, askush nuk mund të kontestojë efikasitetin e federalizmit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadasë, Australisë, Zvicrës, Belgjikës dhe shteteve të shumta të

demokracive në botë.

Madje edhe shtetet që i afrohen më së shumti përbërjes monoetnike të popullsisë, si Gjermania dhe Austria, kanë zgjedhur modelin federativ, si model më efikas.

Domosdoshmëria e tejkalimit të formës unitare të shtetit të Maqedonisë bëhet edhe më urgjente kur dihet fakti se edhe shtetet që janë themeluar mbi modelin e filozofisë jakobiniste janë shumë më të decentralizuara se Maqedonia.

Kur Gjermania si shtet, popullsia e së cilës ka një gjuhë dhe një fe, aplikon sistemin federativ të organizimit politik, atëherë pse Maqedonia, në të cilën dy kombet numerikisht më të mëdha (maqedonasit dhe shqiptarët) nuk kanë as gjuhë, as fe dhe as kulturë të përbashkët, duhet të funksionojë si shtet unitar ?!

“Argumetet”, se gjoja ndërkombëtarët sugjerojnë këtë model të organizimit politik për Maqedonisë, janë banale dhe ironike në të njëjtën kohë.

Cili “ndërkombëtar” që vjen nga shtetet e demokracive perëndimore, i lindur dhe i edukuar në frymën e tolerancës dhe respektit të diversitetit etnik, gjuhësor, kulturor dhe fetar, do të na sugjeronte modelin e organizimit politik që gjeneron tensione dhe konflikte të vazhdueshme?

Federatat demokratike mbijetuan shekujt dhe dëshmuar efikasitet të madh me organizimin politik në interes të diversitetit etnik, gjuhësor, kulturor dhe fetar.

Diktaturat, qofshin edhe në formë federate të tipit sovjetik apo jugosllav, përfunduan me shpartallime.

Shpartallimi i Federatës Jugosllave është shumë i freskët, siç janë të freskëta edhe qëndrimet e të gjitha atyre që nuk pranonin të ndryshonin Kushtetutën dhe nuk pranonin t’i trajtonin shqiptarët e Kosovës si të barabartë.

Idhtarët e ruajtjes së status quo-së të asaj kohe mund të shkojnë nëpër arkiva shtetërore apo biblioteka dhe me nostalgji të lexojnë atë Kushtetutë. Sot Kosova është shtet i pavarur dhe popujt tjerë nuk pranuan të jetojnë nën diktatin e Beogradit.

E njëjta gjë do të ndodhë edhe në Maqedoni. Referendumi i organizuar më 11 dhe 12 janar të vitit 1992 dëshmoi në mënyrë unanime vullnetin për Autonomi politike dhe territoriale të shqiptarëve në Maqedoni.

Populli shqiptar nuk do të pranojë që vullneti i tij politik të nëpërkëmbet dhe t'i imponohet të jetojë nën diktaturë, qofshin ato edhe «diktatura multietnike» të unitarizmit maqedonas!

Bashkimi Demokratik Shqiptar do të angazhohet për ridefinimim e Maqedonisë si shtet binacional, zyrtarizimin e gjuhës shqipe në të gjitha nivelet e institucioneve shtetërore (me status të barabartë e jo si gjuhë e dytë) dhe gjetjen e formave më të përshtatshme të shprehjes së sovranitetit nga poshtë lart (krahina autonome, regjione, kantone, etj.) si rrugë e vetme që Maqedonia t'i plotësojë nevojat e shqiptarëve në pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare.

# KËRKESË PËR KONFERENCË TË RE NDËRKOMBËTARE PËR MAQEDONINË

- Mosrespektimi i Konventave ndërkombëtare, nënshkruese e të cilave është edhe shteti i Maqedonisë,
- Mosrealizimi i “Marrëveshjes së Ohrit”, që i dha fund luftës dhe nuk ndërtoi paqen,
- Dhuna, terrori dhe diskriminimi i vazhdueshëm racial që shteti i Maqedonisë aplikon kundër shqiptarëve autokton, nga populli shqiptar i Maqedonisë krijuan popullin më të shtypur dhe më të diskriminuar në Evropë.

Kjo politikë agresive dhe antishqiptare e institucioneve shtetërore të Maqedonisë është katalizator i konflikteve të reja në këtë shtet, si dhe bartë me vete rrezikun e destabilizimit të Evropës Juglindore.

Situata është tejet dramatike dhe bartë me vete rreziqe të mëdha.

Kjo situatë kërkon që forcat politike kombëtare dhe ndërkombëtare të veprojnë me mençuri për të dëshmuar kapacitetet preventive të një konflikti me përmasa të paparashikuara.

Çdo neglizhencë e kësaj situatë na bën përgjegjës të gjithëve dhe secilin në përputhje me peshën e vet politike në skenën kombëtare dhe ndërkombëtare.

Për këtë arsye, dhe me qëllim që të ndërtohen raporte të reja paqësore në këtë pjesë të Evropës, Bashkimi Demokratik Shqiptar kërkon nga partitë politike shqiptare në Maqedoni, nga intelektualët dhe personalitetet e jetës publike, nga rinia studentore nga pjesa më vitale e popullit shqiptarë që ndodhet në emigracion që unanimisht të mbështetet kërkesa për domosdoshmërinë e organizimit të një Konferencë të Re për Maqedoninë, në të cilën:

- bëhet bilanci 10 vjeçar i mosrealizimit të plotë të «Marrëveshjes së Ohrit»;
- imponohet amnisti e përgjithshme për të dënuarit në proceset e montuara nga motive të urrejtjes etnike dhe fetare;

- riparohen dëmet ekonomike që u janë shkaktuar shqiptarëve;
- gjendet forma e organizimit shtetëror që do të garantonte zhvillimin e harmonishëm të diversitetit etnik, kulturor, linguistik dhe fetar;
- krijohet një mision ndërkombëtar për implementimin dhe monitorimin e konkluzioneve të kësaj konference.

Bashkimi Demokratik Shqiptar kërkon nga institucionet shtetërore të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, nga partitë politike që veprojnë në Shqipëri dhe Kosovë, nga Akademitë e shkencave të dy shteteve, nga institucionet shkencore, nga organizatat joqeveritare, nga intelektualët e pavarur, nga emigracioni, i cili i mbajti mbi supet e veta tri luftërat e fundit çlirimtare në hapësirat shqiptare, që të ngrenë zërin e protestës dhe të mbështesin kërkesën për një Konferencë të Re Ndërkombëtare e cila duhet t'i japë fund vuajtjeve dhe diskriminimit racial të shqiptarëve në Maqedoni!

*Bashkimit Demokratik Shqiptar  
Bardhyl Mahmuti - Kryetar  
21 mars, 2011*

# Përmbajtja

Vizionet e hapsirës shtetërore në ballkan dhe shqiptarët.....	2
Shpartallimi i diktaturave komuniste dhe aderimi në sistemin demokratik.....	8
«Marrëveshja e Ohrit» - Marrëveshje që përfundoi luftën por nuk ndërtoi paqen.....	14
Diskriminimi racial në Maqedoni.....	21
Në vend të "amnistisë" - likuidime fizike dhe dënime në proceset e montuara gjyqësore.....	22
Diskriminimi ekonomik.....	24
Diskriminimi i fëmijëve.....	27
Diskriminimi në kulturë.....	30
Maqedonia dhe institucionet euro-atlantike.....	36
Federalizimi - prespektivë reale për Maqedoninë.....	39
Kërkesë për konferencë të re ndërkombëtare për Maqedoninë.....	43

KONFERENCË NDERKOMBËTARE  
PËR MAQEDONINË

